



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2025:016461
Datë: 26.02.2025
Numri i dokumentit: 06903284

NË EMËR TË POPULLIT

K.nr. 65/25

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE DEGA LIPJAN – DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE, sipas gjyqtarit Selman Salihu me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Vesa Bajrami, duke vendosur në procedurë kundërvajtëse kundër të pandehurit B. B. nga fsh.S. K.G., për shkak të veprës së kundërvajtjes nga neni 249 par. 2 të Ligjit 08/L-186 për rregullat e trafikut rrugor, e në bazë të neneve 27, 55, 56, 77 par.1.1., nenit 127 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me datën 25.02.2025. merr këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

B. B., nga i ati J., i lindur me dt.... në fsh.R. K.L., me vendbanim në fsh.S. K.G., i martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal ... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovë.

ESHTE PERGJEGJES

Sepse:

Me dt.19.12.2024 rreth orës 14:00h ka ka ndodhur aksident I komunikacionit rrugor me lëndime trupore mes dy automjeteve.Bazuar ne vendin ngjarjes si dhe deklaratave te pjesmarrsve në aksident,dyshohet se deri te aksidenti kishte ardhur kur Auto A kishte qenë duke lëvizur ne rr." A. K."në L. dhe me te arritur ne udhkryqin në S. kishte filluar ta kaloj rrugen ne drejtim te fsh. S., dhe derisa ishte duke levizur udhkryq nga drejtimi QMI-së kishte ardhur auto B the e kishte goditur auto A.Auto B me pjesen ballore e kishte goditur auto A ne anen e djathtë pjesa e pasme.Si pasojë e akskidenttit lendime te lehta kishte pesaur shoferi I auto B i cili kishte kerkuar ndihme mjeksore, ku pas trajtimit ne QKUK-në Prishtinë ishte liruar per ne shtepi.

-Me këtë ka kryer vepër kundërvajtëse nga nga neni 249 par.2 te të Ligjit 08/L-186 për rregullat e trafikut rrugor, Andaj në bazë të të njejtit nen dhe ligj të pandehurit i,

SHQIPTOHE T

QORTIM GJYQËSOR, konform nenit 27. par. 1.1 te LMK-së.

Shpenzime procedurale nuk ka pasur .

Me nga një kopje të këtij aktgjykimi njoftohet i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës.

Arsyetim

NJRKRR-Fushë Kosovë me kërkesën me nr. të lëndës 2024-AR-3730 të dt.27.01.2025 ka kërkuar për zhvillimin e procedurës kundërvajtës kundër të pandehurit , për vepër te kundërvajtjes të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ne baze te kerkeses se parashtruar ka marre ne pytje te pandehurin i cili gjate marrjes ne pytje me procesverbal e ndin veten pergjegjes per vepren kundervajtese qe i vihet ne barre te pershkruar si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Gjykata e mbeshtetur ne kerkesen e parashtruar duke administruar dhe vlerësuar provat veq e veq dhe te gjitha bashkarisht sipas bindjes se lire kostaton se është vërtetuar ne mase te mjaftuar se ne veprimet e te pandehurit ekzistojne elementet dhe tiparet e vepres kundervajtëse te nga neni 249 par.2 i LRRTRR-së.

Gjykata beri zbutjen e denimit ndaj te pandehurit duke aplikuar dispozitat e nenit 35 te LMK-së.

Me rastin e marrjes se ketij aktgjykimi gjykata pati parasyshe rrethanat lehtesuese dhe renduese te kryerjes se vepres kundervajtese, sjelljet e te pandehurit pas kryerjes se vepres kundervajtese shkallen e pergjegjesise, pendimin per kryerjen nje kundervajtje te tille, duke shpresuar se me kete ka arritur qellimi i denimit dhe se do te kete efekt pozitiv qe ne te ardhmen ti shmanget kryerjes se kundervajtjeve te njejte apo te ngjashme.

Nga arsyet e cekura me larte u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË LIPJAN - DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE

K.nr.65/25 me dt. 25.02.2025.

Keshilla Jurdike: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8. ditësh Gjykatës së Apelit në Prishtinë Divizionit për Kundervajtaje përmes kësaj gjykate.

GJYQTARI
Selman Salih